



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 2088 Nr. i fag./Br.str./No.pg 12

Data/Datum/Date 8 / 9 / 23

RAHOVEC / ORAHOVAC

Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt - buxhetin e komunës për vitin 2024

Shtator 2023

Hyrje

Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit ka prezantuar projekt - buxhetin për vitin 2024-2026.

Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2024, në total prej 20.034.785.00 Euro, ku ky buxhet është ndarë në kategori, si:

1. Paga dhe Mëditje, në shumën prej 10.300.983.00 euro;
2. Mallra dhe Shërbime në shumën prej 2.466.340.00 euro;
3. Shpenzime komunale, në shumën prej 370.000.00 euro;
4. Subvencione dhe transfere në shumën prej 890.00.00 euro;
5. Investime Kapitale në shumën prej 6.007.462.00 euro;

Krahasuar me vitin 2023, kemi rritje të buxhetit prej 2.486.545.00 euro.

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt - buxhetin e vitit 2024

Kryetari i Komunës, më 8 qershor, ka marrë vendim për caktimin e Grupit punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2024-2026.

Grupi punues për hartimin e projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2024-2026, në këtë përbërje:

1. Ekrem Bytyqi – Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kryesues
2. Qëndresa Kryeziu – Drejtoria për Buxhet dhe Financa, anëtare
3. Ardian Rama – Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
4. Antigona Krasniqi – Drejtoria për Arsim, anëtare
5. Fjolla Duraku – Zyrtare për Lektorim, anëtare
6. Muharem Morina – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
7. Artan Asllani – Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, anëtar
8. Hasan Vuçitërna – Drejtoria për Bujqësi, anëtar
9. Petrit Haxhijaha – Drejtoria për Administratë, anëtar

Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Projekt-buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2024-2026, të bëjë hartimin e Planit të brendshëm komunal për mbarëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktojë personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëjë hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike, të bëjë hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetor dhe ta përgatisë për ta dërguar në Kuvendin Komunal.

Bazuar në vendimin e kryetarit, grupi punues ka mbajtur disa takime radhazi, duke bërë Planin e veprimit për dëgjimet buxhetore, përpilimin e kalendarit të dëgjimeve buxhetore dhe njoftimeve për publikim.

Plani i veprimit ka përfshirë organizimin e dëgjimeve publike nga ekzekutivi gjatë periudhës korrik-gusht, si dhe organizimin e dëgjimit buxhetor nga Kuvendi Komunal përkatësisht Komiteti për Politikë dhe Financa, 13 shtator.

Ekzekutivi komunal ka organizuar gjithsej njëmbëdhjetë dëgjime publike buxhetore. Njoftimi, kalendari, Plani i veprimit dhe një dokument i detajuar mbi buxhetin, janë publikuar në ueb - faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit, në Platformën Qeveritare për Konsultime Publike, në rrjete sociale, janë dërguar ftesa përmes rrjeteve sociale, e-maileve dhe direkt përmes thirrjeve telefonike, duke i ftuar pjesëmarrësit që të bëhen pjesë direkte e përgatitjes së buxhetit.

Publikimi u bë me kohë më 28 korrik 2023, ashtu siç parasheh Udhëzimi për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike:

Njoftimi: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2023/08/Njoftim-publik-per-degjim-buxhetor-me-Shogaten-Hendikos-dhe-Kryqin-e-Kuq.pdf>

Kalendari: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2023/07/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PUBLIKE-ME-QYTETARE-PER-BUXHETIN-E-VITIT-2024.pdf>

Plani i Veprimit: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2023/07/PLANI-I-ORGANIZIMIT-TE-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PER-VITIN-2023.pdf>

Dokumenti i specifikuar i buxhetit: https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2023/05/Qarkoria-Buxhetore-2024_01.pdf
<https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2023/08/Qarkoria-Buxhetore-2024-02.pdf>

Platforma Qeveritare për Konsultime Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/meetings.php?InstitutionID=20529&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Dëgjimet publike buxhetore

Procesi i dëgjimeve buxhetore filloi më 14 gusht, deri më 18 gusht 2023, me gjithsej 11 dëgjime publike, në të cilat qytetarët dhe grupet e interesit patën mundësi të paraqesin kërkesat dhe sugjerimet për një buxhetim sa më gjithëpërfshirës.

Metodat e konsultimit	Data/ Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime
1. Takim i drejtpërdrejtë Banorëve dhe Kryqi i Kuq i Kosovës	14.08.2022 1 orë	9 pjesëmarrës 0 femra	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
2. Takim i drejtpërdrejtë në Sallën e Kuvendit me OJQ, përfaqësuesit e shkollave, rinisë, biznaset, femrat	14.08.2022 40 minuta	21 pjesëmarrës 7 femra	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
3. Takim i drejtpërdrejtë në SHFMU "Gëzim Ramza" me komunitetin joshumicë	15.08.2022 50 minuta	21 pjesëmarrës 9 femra	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa

4. Takim i drejtpërdrejtë në shoqatën "Harcje" me buxhetimin gjinor	15.08.2023 1 orë	22 pjesëmarrës 22 femra	6 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
5. Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë të fshatrave: Ratkoc, Dejnë, Malësi e Vogël, Vrajakë, Bratotin, Gexhtë	15.08.2023 55 minuta	36 pjesëmarrës 0 femra	11 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
6. Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë të fshatrave: Krushë e Madhe, Celinë, Nagac, Brestoc, Hoçë e Vogël	16.08.2023 40 minuta	14 pjesëmarrës 2 femra	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
7. Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë të fshatrave: Xërrë, Fortesë, Pataqan i Poshtëm, Sapunig	16.08.2023 1 orë	20 pjesëmarrës 0 femra	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
8. Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë të fshatrave: Drenoc, Pastasel, Senoc, Zatriq, Kazmik, Pataqan i Epërm, Nashpall	17.08.2023 35 minuta	6 pjesëmarrës 0 femra	2 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa

9. Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë të fshatrave: Çifllak, Kramovik, Dobëdal, Guri i Kuq, Mbrasor, Folluzhë	17.08.2023 45 minuta	15 pjesëmarrës 0 femër	8 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
10. Takim i drejtpërdrejtë në sallën e Kuvendit Komunal me qytetarë të lagjeve: 1, 2, 3, 4 dhe 5, në Rahovec	18.08.2022 40 minuta	24 pjesëmarrës 5 femër	4 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
11 Takim i drejtpërdrejtë me qytetarë të fshatrave: Opierrushë, Zoqësihtë, Retijë dhe Retijë e Epërme	18.08.2023 40 minuta	11 pjesëmarrës 1 femër	7 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa
Publikimi në ueb - faqe / platforma elektronike	14 ditë para dëgjimit publik		Asnjë koment nuk kemi marrë

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike, si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo të refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Projekt - buxheti i vitit 2024, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më *1 shtator 2023*, do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Rahovecit.

Shtojca 1 – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sugjerim për projekt - buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht i pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Projekt - buxheti i vitit 2024 Dëgjim buxhetor me shoqatën Handikos dhe Kryqin e Kuq në Rahovec	1. Kërkesë për aktivizimin e aktiviteteve për fëmijët me nevoja të veçanta	Haxhi Hoxha, nga Shoqata Hendikos	1. I pranuar	1. Aktivitetet për fëmijë me nevoja të veçanta, do të financohen dhe mbështeten nga Komuna e Rahovecit.
	2. Rrethimi i objektit të shoqatës së Handikos		2. I pranuar	2.Komuna e Rahovecit ka kontratë për rrethimin e objekteve publike.
	3. Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve të rrymës		3. I papranuar	3.Deri në funksionalizimin e plotë të shoqatës Hendikos.
	1. Shtrimi i kubëzave në oborrin e objektit të Kryqit të Kuq	Qerim Cena, Kryqi i Kuq	1. I pranuar	1. Komuna e Rahovecit ka kontratë për kubëzim.
	2. Rrethimi i objektit të shoqatës së Kryqit të Kuq		2. I pranuar	2.Komuna e Rahovecit ka kontratë për

	3. Izolimi i kulmit të objektit të Kryqit të Kuq 4. Vendosja e kamerave në objekt		3. I pranuar 4. I pranuar	rrethimin e objekteve publike. 4.Në kuadër të marrëveshjes për shfrytëzimin e objekteve publike është e paraparë mirëmbajtja e këtyre objekteve nga shfrytëzuesit. 4.Nuk është paraparë buxhet për projekte të tilla në vitin 2024.
	1.Regullimi i infrastrukturës adekuate për persona me nevoja të veçanta 2.Nevojë për një punëtor teknik për mirëmbajtjen e objektit të Shoqatës së Handikosit 3.Kërkesë për furnizim me barna esenciale në QKMF	Selman Shtavica, anëtar i Shoqatës "Handikos" :	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar	1.Komuna e Rahovecit ka kontratë aktive për rregullimin e infrastrukturës publike. 2.Deri në funksionalizimin e plot të shoqatës "Handikos". 3.QKMF-ja furnizohet me barna esenciale nga komuna e Rahovecit dhe nga Ministria e Shëndetësisë.

				1.Në bashkëpunim me DKA, DKRS dhe DSHMS, do të organizojnë ligjërata, sipas kërkesës së shoqatës.
	1. Të mbahen disa ligjërata nga institucionet e Arsimit në Shoqatën “Handikos” për fëmijët me nevoja të veçanta.	Bajram Morina, anëtar i Shoqatës Handikos	1. I pranuar	2.QKMF-së në Rahovec, sipas udhëzimit administrativ nuk i lejohej ofrimi i shërbimeve sekondare shëndetësore.
	2. Mungesa e fizioterapeutit (sepse pajisjet janë jashtë funksionit për arsye të mospërdorimit të tyre).		2. I papranuar	3.Në konkurset e hapura publike, inkurajojmë të gjithë personat me nevoja të veçanta të aplikojnë.
	3. Punësimet e personave me nevoja të veçanta në institucione publike dhe private.		3. I pranuar	

Dëgjim buxhetor në Sallën e Kuvendit me OJQ, përfaqësues të shkollave, rininë, bizneset, fermer.	1. A janë të përfshira të gjitha sportet në buxhetin e Komunës dhe a do të vazhdojë përkrahja edhe në vitet në vijim	Myrtez Shala, <i>përfaqësues i sportit</i>	1. I pranuar	1.Kryetari i komunës dhe DKRS-së, ka subvencionuar të gjitha klubet sportive.
	1. A do të ketë rritje të Buxhetit në Mallra dhe Shërbime, posaçërisht për lëndë djegëse për shkollat e komunës së Rahovecit	Elhami Zhuniqi, drejtor i shkollës fillore “Liria”, Fortesë	1. I pranuar	1.Buxheti për mallra dhe shërbime do të ketë rritje për vitin 2024.
Dëgjim buxhetor në SHFMU “Gëzim Hamza” Me komunitetin joshumicë	1. Mungesa e banimit, sepse jemi shumë anëtarë të cilët jetojmë në një dhomë	Ardiana Kryeziu, qytetare e Rahovecit	1. I pranuar pjesërisht	1. Komuna e Rahovecit paguan qira për shumë familje, në mungesë të buxhetit, nuk mund të ndërtohen shtëpi të reja.
	1. Mungesa e ndriçimit publik afër shkollës dhe 2. Mungesa e parkingut afër Shkollës “Gëzim Hamza”.	Xhemajli Isaku, qytetar i Rahovecit	1. I pranuar 2. I pranuar	1.Do të vazhdojë riparimi i ndriçimit publik. 2.Sipas mundësisë dhe hapësirës

				publike në afërsi të shkollës do të rregullohen parkingjet.
	1. Mungesa e kanalizimit në lagjen e komunitetit, afër Shkollës "Gëzim Hamza", Ndërtimi i një parku në lagjen e komuniteteve	Xhevat Hasani, qytetar i Rahovecit	1. I pranuar	1.Ndërtimi i një segmenti të kanalizimit në këtë lagje është i paraparë në projektin e bashkëfinancuar me MAPL-në.
Dëgjim buxhetor në shoqatën "Hareja"	1.			
Buxhetimi Gjinor	1. Një punëtor për projektin e aktiviteteve të grave të moshuara	Adelina Paçarizi, OJQ "Hareja"	1. I pranuar pjesërisht	1.Do të shohim mundësinë e angazhimit të një punëtori si konsulent.
	2. Buxhet për ditë të gruas, 8 Mars, 1 dhe 2 Tetor		2. I pranuar	2.Komuna e Rahovecit në vazhdimësi ndan mjete për shënimin e ditëve ndërkombëtare.
	3. Ndriçimi publik te ndërtesat afër KEDS-it dhe të rregullohet parku dhe vendosja e ulëseve		3. I pranuar	3.Do të vazhdojë vendosja e rrjetit dhe riparimi i ndriçimit publik.
	4. Rregullimi i ndriçimit të rrugës "Sylejman Hoxha"		4. I pranuar	4. Do të vazhdojë vendosja e rrjetit dhe riparimi i ndriçimit publik.

**Dëgjim
buxhetor me
qytetarë të
fshatrave:
Ratkoc, Dejnë,**

1. Mungesa e rrymës në lagjen “Vëllezërit Frashëri”.	Afrore Miftari, qytetare nga Rahoveci	1. I pranuar	1. Do të vazhdojë vendosja e rrjetit dhe riparimi i ndriçimit publik.
1. Mbështetje financiare për bizneset që udhëhiqen nga gjinia femërore	Blerina Hajda, qytetare nga Rahoveci	1. I pranuar	1. Komuna ka mbështetur në vazhdimësi të gjitha OJQ-të dhe bizneset përmes thirrjes së subvencioneve.
1. Rruga e parkut - kërkesë për kubëzim	Florije Rama, qytetare nga Rahoveci	1. I pranuar	1. Komuna e Rahovecit ka kontratë aktive për rregullimin e infrastrukturës publike.
1. Zgjerimi i kanalizimit në disa pjesë të fshatit 2. Rregullimi i përrenjve - vazhdimi i tyre.	Beqë Shala, kryetar i fshatit Ratkoc	1. I pranuar 2. I pranuar	Komuna e Rahovecit ka kontratë aktive për rregullimin e

Malësi e Vogël, Vrajakë, Bratotin, Gexhë	3.Ndërtimi i trotuarit prej Ratkocit deri në Dejnë.		3. I pranuar	infrastrukturës publike (kubëzimi, ndriçimi, kanalizimet).
	4.Zgjerimi i ndriçimit publik në disa lagje të fshatit,		4. I pranuar	
	5.Rrugët fushore,		5. I pranuar	
	6.Kubëzimi i disa rrugëve në fshat.		6. I pranuar	
	1. Rregullimi i kanalit të tokave bujqësore,	Murat Morina, kryetar i fshatit Malësi e Vogël	1. I pranuar	Për të gjitha kërkesat, Komuna e Rahovecit ka kontrata aktive dhe punimet po vazhdojnë.
	2. Rregullimi i përroit tek Oda e fshatit e deri te hekurudha,		2. I pranuar	
	3. Rregullimi i shtratit prej pikës së grumbullimit të qumështit deri te varrezat,		3. I pranuar	
	4. Rrugët fushore,		4. I pranuar	
	5. Rregullimi i rrugës te varrezat afër Drinit,		5. I pranuar	
	6. Trotualet prej hekurudhës deri te qendra e fshatit,		6. I pranuar	
	7. Rrugët e disa lagjeve, 600 deri 700 metra, afër shkollës te Musa Met,		7. I pranuar	
	8. Kanali i kullimit të tokave nga Ratkoci deri te		8. I pranuar	

	fshati Gexhë nga hekurudha.			
	1. Shtrimi i 3 rrugëve me kubëza, 2. Rregullimi i oborrit të Odës së Fshatit Gexhë, 3. Kanali i kullimit te qendra e fshatit deri te hekurudha 200 – 400 metra, 4. Kanalizimi në lagjen e Gradishit.	Nexhmedin Krasniqi, kryetar fshatit Gexhë	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar	Për të gjitha kërkesat, Komuna e Rahovecit ka kontrata aktive dhe punimet po vazhdojnë.
	1. Rruga e degëzimit Vrajakë-Bratotin-Ratkoc, të riparohet sepse është dëmtuar. 2. Rrugët fushore Vrajakë, Bratotin, 3. Trotuari te rruga e Arashit te shkolla që lidh dy fshatrat Vrajakë - Bratotin, 4. Trotuari në rrugën kryesore prej Ratkocit - Vrajakë dhe Bratotin.	Avni Morina, fshati Vrajakë	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar	1. Komuna ka kontratë për mirëmbajtje dhe riparime të rrugëve. 2. Komuna ka kontratë për rregullimin e rrugëve fushore. 3. Komuna ka kontratë për rregullimin e trotuareve.

	1. Rruga "Lulzim Hoti" - shtrimi me kubëza, 2. Uji i pijes, problem me ujë të pijes gjatë sezonit të verës, 3. Ndriçimi publik në rrugën "Lulzim Hoti", 4. Trotuari në rrugën "Lulzim Hoti".	Esat Hoti, qytetar i fshatit Ratkoc	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar	1. Komuna ka kontratë për kubëzimin e rrugëve dhe të rrugicave. 2. Komuna ka memorandum bashkëpunimi me KRU "Gjakova" për rregullimin e ujit të pijshëm. Komuna ka kontratë aktive për ndriçim publik dhe trotuare.
	1. Rregullimi i kanalizimit në mes të fshatit, sepse gjatë reshjeve atmosferike, uji depërton nëpër shtëpitë private.	Bashkim Zena, fshati Malësi e Vogël	1. I pranuar	1. Rregullimet në këtë segment janë të parapara dhe punimet po vazhdojnë.
	1. Rrethimi i oborrit të Shkollës së Mesme "12 Maji" në Ratkoc, mungesa e sigurisë në shkollë, 2. Uji i pijes, problem me ujë të pijes gjatë sezonit të verës,	Gani Hoti, fshati Ratkoc	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar	1. Në kuadër të projektit: rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të objekteve publike, janë të parapara investimet e kësaj natyre.

	3. Ndriçimi publik afër Shkollës "12 Maji", 4. Ndriçimi publik tek Ambulanca në Ratkoc.			2. Komuna ka memorandum bashkëpunimi me KRU "Gjakova" për rregullimin e ujit të pijshëm. Komuna ka kontratë aktive për ndriçim publik.
	1. Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Rugën "Arben Bytyqi", 2. Rregullimi i rrugëve fushore dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese, 3. Ndërtimi i urës te Hekurudha, 4. Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni për rrugën "Arben Bytyqi" në gjatësi 200 metra, Rruga tek automekaniku Muhamet Bytyqi, si dhe rrugët e tjera, 5. Intervenimet në kanalizimin e fshatit për shkak se po shkaktohen vërshime gjatë reshjeve atmosferike.	Valmir Bytyqi, qytetar i fshatit Dejnë	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar 5. I pranuar	Për të gjitha kërkesat, komuna e Rahovecit ka kontrata aktive dhe punimet po vazhdojnë.
	1. Rregullimi i përroit nga fshati	Mustafë Krasniqi,	1. I pranuar	1. Komuna ka kontratë për

Dëgjimi buxhetor me qytetarë të fshatrave: Krushë e Madhe, Celinë, Nagac, Brestoc, Hoçë e Vogël	Gexhë, deri në Radoste	<i>fshati Malësi e Vogël</i>		rregullimin e përroskave.
	1. Ndërtimi i kanalizimit në drejtim nga fshati Dejnë, te hekurudha	Bujar Hoti, fshati Ratkoc	1. I pranuar	1. Komuna ka kontratë për rregullimin e kanalizimeve.
				1. Në kuadër të
	1. Rruga te përroi i biçecve, pengesa nga vërshimet.	Ali Morina, fshati Ratkoc	1. I pranuar	kontratës për mirëmbajtje që ka Komuna, do të evitohet ky problem.
	1. Përroska te fshati Celinë- Krushë e Madhe të përfundohet brenda vitit 2024, 2. Fusha sportive, 3. Shtëpia - muze "Bajram Curri" të ndërtohet, 4. Rrugët fushore, 5.Stadiumi, qendra sportive në Krushë e Madhe	Sejfullah Sejfullahu, Krushë e Madhe	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar 5. I pranuar pjesërisht	Në kuadër të kontratave që ka Komuna e Rahovecit, këto kërkesa adresohen në implementim të projekteve. 5.Kërkesa është adresuar në MKRS.
	1. Rrugët dytësore për shtrim, gjithsej 18 rrugë; (2.2 km), 2. Ndriçimi publik, 3. Kanalizimi i një lagjeje në fshat, 4. Rrugët fushore	Afrim Dina, qytetarë i fshatit Celinë	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar	Për të gjitha kërkesat, Komuna e Rahovecit ka kontrata aktive dhe punimet po vazhdojnë.

Dëgjimi buxhetor me qytetarë të fshatrave: Xërxë, Fortesë, Pataqan i Poshtëm, Sapniq	1. Rrugë fushore, 2. Rregullimi i disa rrugëve të lagjeve me kubëza, 3. Ndriçimi publik në rrugën kryesore	Dafina Gashi, qytetare e fshatit Nagavc	1. I pranuar 2. I pranuar 3. I pranuar	Për të gjitha kërkesat, Komuna e Rahovecit ka kontrata aktive dhe punimet po vazhdojnë.
	1. Rruga prej xhamisë, deri te Çerdhja e fëmijëve, të ndërtohet.	Fatmir Sejfullahu, qytetar i fshatit Krushë e Madhe	1. I pranuar pjesërisht	1.Sipas mundësisë buxhetore, do të trajtohet kjo kërkesë.
	1. Kanalizimi për 8 shtëpi - lagjja kah Drini, 2. Problem me trafon e rrymës, afër 40 familje, 3. Ndriçimi publik në një pjesë të fshatit Xërxë	Safet Thaqi, qytetar nga fshati Xërxë	1. I pranuar 2. I pranuar pjesërisht 3. I pranuar	1. Komuna e Rahovecit ka kontratë aktive për rregullimin e kanalizimeve. 2. Ky investim varet nga KEDS-i. 3. Komuna e Rahovecit ka kontratë aktive për ndriçim publik.
	1. Rrugë me kubëza për 8 familje (kjo rrugë është në pronësi private). 2. Kanalizimi për dy lagje 3. Problem me trafon e rrymës për disa familje, 4. Rreth - rrotullimi tek udhëkryqi	Mensur Gashi, Sapniq	1. I pranuar pjesërisht 2. I pranuar 3. I pranuar pjesërisht	1. Kjo kërkesë aprovohet në momentin që qytetarët, që janë pronarë në këtë rrugë, e nënshkruajnë deklaratën në Kadastër.

	Fortesë – Sapniq - Pataqan, 5. Rruga që lidh Sapniqin dhe Ratkocin afër 180m, të shtrohet me asfalt		4. I pranuar 5. I pranuar pjesërisht	2. Komuna e Rahovecit ka kontratë aktive për kanalizim. 3. Ky investim varet nga KEDS-i. 4. Komuna ka kontratë për rregullimin e infrastrukturës publike. 5 Në bazë të mundësive buxhetore.
	1. Rrethimi i varrezave dhe rregullimi i infrastrukturës përreth varrezave (varrezat në dalje të fshatit për Rugovë), 2. Rruga “ 5 Maji” të kubëzohet, 3. Rruga “Mitrush Kurteli”, problem me kanalizim dhe të rregullohet kjo rrugë me kubëza.	Ibrahim Kryeziu, qytetar nga fshati Xërxë	1. I papranuar 2. I pranuar 3. I pranuar	1. Deri më tani, Komuna nuk ka investuar në rrethimin e varrezave. 2. Komuna ka kontratë për kubëzimin e rrugëve. 3. Komuna ka kontratë për kubëzimin e rrugëve dhe rrjetin e kanalizimit.

Dëgjim buxhetor me qytetarë të fshatrave: Drenoc, Pastasel, Senoc, Zatriq, Kaznik, Pataqan i Epërm, Nashpall			1. I pranuar	1,2. Komuna ka kontratë për kubëzimin e rrugëve dhe rrjetin e kanalizimit.
	1. Kubëzimi i rrugëve afër 1500 metra, 2. Kanalizimi afër 700-800 metra (gropa septike), 3. Problem me trafon e rrymës, afër 30 familje, 4. Shtegu i ecjes, 5. Rregullimi i rrugëve fushore	Afrim Krasniqi, qytetarë i fshatit Pastasel	2. I pranuar 3. Pjesërisht i pranuar 4. Pjesërisht i pranuar 5. I pranuar	3. Kjo kërkesë varet nga investimet e KEDS-it. 4. Sipas mundësive buxhetore, kërkesa do të merret parasysh. 5. Komuna ka kontratë dhe po vazhdojnë investimet në rregullimin e rrugëve fushore.
	1. Rregullimi i infrastrukturës së hapësirës së oborrit të Shtëpisë së Odës së Fshatit, afër 600m ²	Jeton Krasniqi, qytetarë i fshatit Pastasel	1 I pranuar pjesërisht	1. Do të shikojmë mundësitë buxhetore brenda kontratës ekzistuese.
Dëgjimi buxhetor me qytetarë të	1. Fusha e sportit brenda oborrit të shkollës fillore në fshat.	Maliq Fetahu, Guri i Kuq	1. I pranuar	1. Të planifikuara në kontratën e cila pritet të lidhet këtë vit, është edhe ky projekt.

fshatrave: Çifllak, Kramovik, Dobidol, Guri i Kuq, Mrasor, Polluzhë	1. Rruga "Sadri Thaqi" të kubëzohet afërsisht 200 metra.	Fatmir Thaqi, Kramovik	1. I pranuar	Komuna po vazhdon kubëzimin e rrugëve në tërë territorin e komunës.
				1. Komuna po vazhdon investimet në rrjetin e kanalizimit, në tërë territorin e komunës.
	1. Kanalizimi i tri lagjeve, si: Kasmaj;s, Kaznikut, dhe te Lokali i Canit, 2. Trotuari te lokali i Qamilit, 3. Sinjalizimi i rrugëve në fshat nga ambulanca, 4. Kubëzimi i disa rrugicave në fshat.	Selajdin Gashi, kryetar i fshatit Çifllak	1. I pranuar 2. Pjesërisht i pranuar 3. I pranuar 4. I pranuar	2. . Kjo kërkesë aprovet në momentin që qytetarët, që janë pronarë në këtë rrugë, e nënshkruajnë deklaratën në Kadastër. 3,4. Komuna po vazhdon kubëzimin e rrugëve në tërë territorin e komunës.
	1. Kubëzimi i disa lagjeve, si: Lagjja Kelmendi, Lagjja Thaqi,	Binak Berisha, kryetar i fshatit Kramovik	1. I pranuar	1,2. Komuna po vazhdon kubëzimin e rrugëve dhe rrjetin

	dhe Lagjja e berishve, 2. Kanalizimi në lagjen Kelmendi, 3. Probleme me qentë endacakë - të bëhet zgjidhja,		2. I pranuar 3. I pranuar	e kanalizimit në tërë territorin e komunës. 3. Komuna ka kontratë për trajtimin e qenve endacakë.
	1. Rregullimi i kanaleve për ujëra atmosferike brenda në fshat, me gjatësi rreth 750 metra dhe rregullimi i një kanali të kullimit tokave, prej hekurudhës deri në lumin “Drini i Bardhë”, në gjatësi prej 1 km., 2. Rregullimi i rrethojës së oborrit të shkollës dhe rregullimi i një fushe sportive për nxënësit e shkollës në Dobidol, 3. Kubëzimi i rrugës që çon te varrezat, rreth 350-600 metra, 4. Riparimi i trotuareve dhe vazhdimi me kubëza deri në Sarosh, me gjatësi 1 km, 5. Rregullimi i rrugëve fushore,	Kujtim Sopjani, kryetar i fshatit Dobidol	1. I pranuar 2. I pranuar. 3. I pranuar 4. I pranuar 5. I pranuar	1. Komuna e Rahovecit, po e vazhdon investimin në rregullimin e kanaleve në tërë territorin e komunës. 2. Në kuadër të projektit: rregullimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të objekteve publike, janë të parapara investimet e kësaj natyre. 3, 4, 5. Komuna po vazhdon kubëzimin e rrugëve në tërë territorin e komunës.

	6. Rregullimi i një shtegu të ecjes rreth 2 km, 7. Rregullimi i lumit të shtratit “Drinit të Bardhë”.		6. Pjesërisht i pranuar 7. Pjesërisht i pranuar	6. Sipas mundësive buxhetore, kërkesa do të merret parasysh. 7. Kërkesa është adresuar në MMPHI.
	1. Sinjalizimi i rrugës te shkolla dhe te betoniera Mendi-p (polic të vdekur), 2. Ndërtimi i një parku afër tyrbes, 3. Rregullimi i rrugës fushore dhe shtegut të ecjes nga Rruga Kryesore, te betoniera Mendi-p, deri te shkolla fillore.	Argjen Berisha, Fshati Kramovik	1. I pranuar. 2. I pranuar 3. Pjesërisht e pranuar	1. Rruga është rajonale, kompetencën e sinjalizimit e ka Ministria e Infrastrukturës. 2. Komuna e Rahovecit ka ndërtuar një park në fshatin Kramovik. 3. Në tërë territorin e komunës, po punohet në rrugët fushore.
	1. Probleme me ujë të pijes. 2. Renovimi i rrugës kryesore në fshat.	Kujtim Rexhepi, kryetar i fshatit Mrasor	1. Pjesërisht e pranuar 2. I pranuar	1. Kjo kërkesë është adresuar në KRU “Gjakova”.

Dëgjim buxhetor në sallën e Kuvendit Komunal me qytetarë të lagjeve: 1, 2, 3, 4 dhe 5 në Rahovec	3. Kubëzimi rreth 200 metra një rruge në fshat, 4. Rrethimi i shkollës dhe rregullimi i infrastrukturës se oborrit të shkollës.		3. I pranuar 4. I papranuar	2, 3. Komuna e Rahovecit është duke intervenuar në rregullimin e infrastrukturës publike. 4. Objekti i shkollës është jashtë funksionit.
	1. Ndërtimi i rrugës së Vreshtave, rreth 350 metra, 2. Trotuari deri te shkolla, në gjatësi prej 560 metra, 3. Drunjtë dekorativë, nga fshatit Gur i Kuq, deri në Fshatin Kramovik përgjatë rrugës, në dy anët e rrugës.	Drilon Mustafa, qytetarë i fshatit Gur i Kuq	1. I pranuar 2. I pranuar 3. i pranuar	Për të gjitha këto kërkesa, Komuna ka kontrata aktive.
	1. Rregullimi i varrezave të viktimave të luftës, gjithsej 38 varre. 2. Ndërtimi i rrugës te fabrika e plastikës, a është bërë zgjidhja e kontestit.	Teki Mustafa, përfaqësues i lagjes Rahovec	1. I pranuar 2. Pjesërisht i pranuar	1. Komuna ka kontratë për rregullimin e varrezave të viktimave të luftës. 2. Lënda është në proces.
	1. Rregullimi i ndriçimit publik te Lumi Duhlo	Gazmend Iska, Rahovec	1. I pranuar	1. Komuna e Rahovecit është duke intervenuar

Dëgjim buxhetor me qytetarë të fshatrave: Opterushë, Zoqishtë, Retijë dhe Retijë e Epërme	(mirëmbajtja, sepse ka prishje prej personave të pandërgjegjshëm			në rregullimin e infrastrukturës publike.
	1. Rruga “Sadedin Hajda” - mungon trotuari, sepse aty kalojnë nxënësit edhe është shumë i nevojshëm rregullimi i këtij trotuari	Naim Kafexhiu, Rahovec	1. I pranuar	1. Në rrugën “Sadedin Hajda”, pjesërisht ka trotuar, në pjesët që nuk ka, janë prona private në të cilën Komuna nuk mund të investojë.
	1. Rruga “Luftëtari”, deri te Transiti lart, afër 100 metra, rregullimi i kësaj rruge me kubëza.	Ajet Cena, Rahovec	1. I pranuar	1. Komuna ka kontratë aktive për rregullimin e infrastrukturës publike.
	1. Ndërtimi i kanalizimit të rruga kryesore te restoranti “Panorama”.	Skender Krasniqi, kryetarë i fshatit Opterushë	1. I pranuar	Për të gjitha këto kërkesa, Komuna ka kontrata aktive, përveç të kërkesa e dytë, ndërtimi i rrugëve lokale, shumica e këtyre rrugësve janë në pronësi private dhe Komuna nuk mund të investojë pa deklaratë në Drejtorinë e Kadastrës.
	2. Ndërtimi i disa rrugëve të lagjeve me kubëza betoni, gjatësia 1 km.		2. I pranuar	
	3. Rrugët fushore gjatësia 10 km.		3. I pranuar	
	4. Meremetimi i varrezave të dëshmorëve dhe rregullimi i lapidarëve.		4. I pranuar	
	5. Rregullimi i dy përrenjve.		5. I pranuar	
	6. Përroi i Vrellës të mbikëqyret		6. I pranuar	

		punimet, sepse ka neglizhencë nga operatori.		7. I pranuar	
		7. Rruga "Besim Kabashi" probleme gjatë reshjeve atmosferike.		8. I pranuar	
		8. Ndriçimi publik i disa lagjeve.		9. I pranuar	
		9. Lumi prej shkollës në drejtim të Zoqishtit.		10 I pranuar	
		10. Deponi për mbeturina të ngurta.			
		1. Rregullimi i kanalit në mes të fshatit (Kanal i hapur) afërsisht 500 metra,	Ilir Kryeziu, Retijë		Për të gjitha këto kërkesa, komuna ka kontrata aktive dhe po vazhdojnë investimet në rregullimin e infrastrukturës publike.
		2. Rregullimi i shtratit të lumenjve nga fshati Opterushë deri në Zoqishtë.	Ilir Kryeziu, Retijë		Për të gjitha këto kërkesa, komuna ka kontrata aktive dhe po vazhdojnë investimet në rregullimin e infrastrukturës publike.
		3. Rrugët fushore rreth 3 km,	Ilir Kryeziu, Retijë		Për të gjitha këto kërkesa, komuna ka kontrata aktive dhe po vazhdojnë investimet në rregullimin e infrastrukturës publike.
		4. Kubëzimi i rrugëve dytësore 1.5 km	Ilir Kryeziu, Retijë		Për të gjitha këto kërkesa, komuna ka kontrata aktive dhe po vazhdojnë investimet në rregullimin e infrastrukturës publike.
		5. Trotualet ka rruga kryesore,	Ilir Kryeziu, Retijë		Për të gjitha këto kërkesa, komuna ka kontrata aktive dhe po vazhdojnë investimet në rregullimin e infrastrukturës publike.
		6. Ndriçimi Publik në disa lagje, pjesë nga shkolla fillore.	Ilir Kryeziu, Retijë		Për të gjitha këto kërkesa, komuna ka kontrata aktive dhe po vazhdojnë investimet në rregullimin e infrastrukturës publike.

	7. Zgjerimi i kanalizimit pjesa për Zoqishtë,			
	8. Rregullimi i fushës së sportit në shkollë,			
	9. Rregullimi i banjave në Shkollën në Retijë të Poshtme,			
	1. Probleme me qentë endacakë	Dardan Kryeziu, Retijë	1. i Pranuar	1. Po vazhdon trajtimi i qenve endacakë.
	1. Probleme më rryme elektrike për shkak të shtyllave të dobët edhe rrjeti i vjetruar, kërkojmë nga ju që të bëni presion KEDS-it që të ndërhyjë në rregullim e këtij problemi	Ardit Spahiu, Opterushë	1. I pranuar	Kërkesa është adresuar në KEDS.
	1. Zgjerimi i rrugës nga Retija deri në Opterushë në të dyja anët e rrugës	Alban Mazreku, Opterushë	1. I pranuar	1. Komuna e Rahovecit, ka paraparë projekt të ri për rregullimin e urave në të gjitha vendbanimet ku ka nevojë.

Totali i kërkesave të qytetarëve në dëgjime buxhetore	144	%
Të pranuar	125	86.81
Të pranuar pjesërisht	12	8.33
Të papranuar	7	4.86

Rahovec, 09.2023

Grupi punues

